



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:015206
Datë: 04.12.2024
Numri i dokumentit: 06549649

C-IV-24-0190

Parashtruesi i kërkesës

F H, Ferizaj, i cili përfaqësohej nga avokati R A tani më i ndjerë

kundër

Pala kundërshtare

Agjencia Kosovare e Privatizimit – (NSH “Gjeravica” në likuidim), Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishte, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 4 dhjetor 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- Kërkesa për kthim në gjendjen e mëparshme refuzohet si e pabazuar.**
- Nuk caktohen shpenzime gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 21 tetor 2014, pranë DHPGJS, ankuesi parashtroj kërkesë, të emërtuar padi, për rishikimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) GJI-057-0214 datë 16 korrik 2014, (në tekstin e mëtutjeshëm: Vendimi), me të cilin i është refuzuar kërkesa për kompensimin e pagave të papaguara, në shumë prej 1,025.00 (një zero dy pesë) Euro, për periudhën nga muaji maj gjer tetor 1990, ndaj NSH “Eurometal” (në likuidim).

Me Aktvendimin e DHPGJS datë 12 qershor 2023, kërkesa për rishikim - ankesa e ankuesit është konsideruar e tërhequr, pasi që ankuesi nuk kishte paguar taksat gjyqësore.

Me 11 tetor 2023, tani bashkëshkurtja e ankuesit, F H të ndjerë, I H ka parashtruar një kërkesë për rikthim në gjendjen e mëparshme. Ankuesja pohon se vërejtja nuk i është dorëzuar ankuesit e as familjarëve të saj, sepse e njëjta ka qenë jashtë shtetit përndryshe taksën do ta paguante.

Arsyetimi ligjor

Kërkesa për kthim në gjendjen e mëparshme konsiderohet e pabazuar.

Në pajtim me nenin 76 paragrafi 3 i Ligjit për DHPGJS, thuhet si në vijim: “ *Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (tani e tutje: LPK).*”

Nga shkresat e lëndës gjykata konstatoj se pohimet e ankueses se vërejtja nuk i paguar ankuesit-paditës gjegjësisht familjarëve, konsiderohen të paqëndrueshme respektivisht të pabazuara.

Nga fletë-kthesa mbi dorëzimin e vërejtjes sipas të dhënave nga zyrtari postar shihet se vërejtja i është dorëzuar vajzës, së ankuesit, me 8 mars 2023. Nga kjo rrjedh se dorëzimi është bërë në pajtim me nenin 111 të Ligjit për procedurën kontestimore.

Andaj nga gjitha arsyet e lartë cekura u vendos si në dispozitiv.

Obiter dictum (ndër të tjerash)

Edhe pse kjo nuk është pjesë e këtij Vendimi, me anë të parashtrësës mbi kthim në gjendje të mëparshme gjykata kuptoj nga bashkëshortja e ankuesit, se ankuesi F H tani më është i ndjerë dhe në favor të kësaj parashtroj Certifikatën e vdekjes, ku shihet se ankuesi ka vdekur me . shtator ..

Sikur gjykata të kishte njohuri mbi këtë fakt, para nxjerrjes së Vendimit datë 12 qershor 2023, atëherë gjykata do të vepronte në pajtim me nenin 277 të LPK dhe do të ndërprente procedurën për shkak të vdekjes së ankuesit por në rastin konkret gjykata asnjëherë nuk është informuar mbi këtë fakt.

Taksat gjyqësore

Nuk caktohen shpenzime gjyqësore.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar